



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 67, datë 26.05.2017

PËR

**KORRIGJIMIN E SITUATËS QË LIDHET ME USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGJENTIT TË BROKERIT TË LICENCUAR TË LETRAVE ME VLERË TË
SHOQËRISË “AKSIONER INTERNATIONAL SECURITIES BROKERAGE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14 dhe 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, si dhe të Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 55, datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në zbatim të Urdhrit nr. 77, dt. 03.05.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, në mbështetje të nenit 19, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, në datat 10 dhe 11 maj 2017, është zhvilluar inspektim në vend, pranë shoqërisë “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a., e miratuar nga AMF për të kryer veprimtarinë e agjentit për llogari të shoqërive të huaja të brokerimit që administrojnë platforma të tregtimit online.

Ky inspektim kishte në fokus: kushtet teknike dhe organizative të këtyre shoqërive dhe kryesisht infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë (si zyrat, pajisjet, personeli), njoftimet dhe reklamat për publikun, mënyrën e identifikimit të klientëve dhe database e tyre, mënyrën e evidentimit dhe raportimit të aktivitetit të kryer për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2016 dhe 1 janar-31 mars 2017, si dhe respektimin e detyrimeve kontraktuale me shoqërinë e huaj të brokerimit.

Me vendimin e Bordit të AMF-së nr. 64, datë 28.04.2011, shoqëria “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a., ka marrë miratimin për të ushtruar veprimtarinë e Agjentit të brokerit në letra me vlerë në emër dhe për llogari të shoqërisë “Saxo Bank”.

Sipas raportimeve të bëra në AMF dhe sqarimeve të dhëna nga administratori, shoqëria “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2016 dhe 1 janar-31 mars 2017 nuk ka ushtruar veprimtari, si agjent i platformës “Saxo Bank”.

Sipas kërkesave të “Saxo Bank” klienti për t’u pranuar në platformë i duhet të investojë të paktën 10,000 euro. Deri në fund të vitit 2015, “Saxo Bank” i krijoi mundësinë shoqërisë “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a., që klientët e kësaj të fundit të investonin në një platformë më të vogël, e quajtur Saxo MT4, kryesisht për instrumentet financiare CFD. Shuma minimale e investimit për këtë platformë ishte e papërcaktuar. Në fund të vitit 2015, “Saxo Bank” e mbylli këtë akses për investitorët shqiptarë.

Konstatohet se aktualisht, kontrata e shoqërisë “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a. me “Saxo Bank” nuk është aktive. Për riaktivizimin e marrëveshjes, “Saxo Bank” kërkon nga shoqëria “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a. një plan biznesi me objektiva tregtare.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Paraqitjen nga shoqëria “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a. të një plani masash miratuar nga organet vendimmarrëse të shoqërisë mbi vijimësinë e veprimtarisë së agjentit të brokerit në përputhje me miratimin e dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
2. Afati për depozitimin e planit të masave të përcaktuar më sipër është brenda datës 30 qershor 2017.
3. Në rast të mosvazhdimin të ushtrimit të veprimtarisë pas afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, shoqëria “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a., do të jetë subjekt i masave të parashikuara në nenin 57, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.
4. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI